

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A6, sfida e re diplomatike e Kosovës për anëtarësim të plotë në Kartën e Adriatikut
ADRESA	https://albeu.com/kosove/a6-sfida-e-re-diplomatike-e-kosoves-per-anetaresim-te-plote-ne-karten-e-adriatikut/1028141/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:33:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:23:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e29a386a457ef4463e463c2c793870875124d6a8868b2f90f45a9108030c40bb
TEKSTI	7f0458aed342f15df7cb96cf161ead9915833a9a4d5cc21b124ae55aa5c5ca3c
PAMJA	b0d25319d9836061aa2a393be7a95b59f50f7241e02f86e4952f2b3f2b7fac59

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d2644f88d7650f8042e25c6e4646f097c8a18e8f7a55906e1377be024b0d620b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d2644f88d7650f8042e25c6e4646f097c8a18e8f7a55906e1377be024b0d620b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

A6, sfida e re diplomatike e Kosovës për anëtarësim të plotë në Kartën e Adriatikut



Thirrja e ministrit të Jashtëm të Kosovës, Glauk Konjufca, që vendi të kalojë nga statusi i vëzhguesit në anëtarësim të plotë në Kartën e Adriatikut ka rikthyer në vëmendje rolin e Kosovës në strukturat rajonale të sigurisë.

Gjatë takimit të asociacionit, Konjufca e lidhi këtë kërkesë me kërcënimet konkrete me të cilat është përballur Kosova, duke përmendur sulmin terrorist në Banjë dhe sulmin ndaj kanalit të Ibër-Lepencit. Sipas tij, Kosova i ka përballuar të dyja ngjarjet dhe ka "triumfuar", duke dëshmuar aftësinë për t'u përballur me rreziqe të sigurisë.

Megjithatë, anëtarësimi i plotë në Kartën e Adriatikut nuk varet vetëm nga argumentet e sigurisë. Për këtë hap nevojitet edhe pajtimi politik dhe diplomatik i vendeve anëtare, ndërsa mosnjohja e Kosovës nga disa shtete, veçanërisht nga Bosnjë-Hercegovina, mund të krijojë pengesa.

Kosova tashmë ka statusin e vëzhguesit në këtë mekanizëm, ndaj kërkesa për shndërrimin e A5 në A6 paraqet një përpjekje për të kaluar në një nivel më të lartë të përfshirjes. Por sa e mundshme është kjo dhe cilat janë veprimet që duhet të ndërmarë Prishtina?

Presidenti i Institutit Shkencor Helvetik të Evropës Jugindore me qendër në Zürich, Dashnim Hebibi, thotë për "Bota sot" se objektivi është i realizueshëm si synim diplomatik. Sipas tij, megjithatë, ai nuk mund të arrihet vetëm përmes deklarimeve publike.

të fundit



Dani Osvaldo shtrohet në terapi intensive pas një komplikacioni të...



Bugatti ndërton në Miami një kullë luksi me vlerë 650 milionë...



Dosti sulmon Ramën pas fjalimit në OKB: E cilëson "antishqiptar t...



Në kërkim për trafik të lëndëve narkotike, 53-vjeçari ukrainas...



Austria në alarm para përballjes me Kosovën, Gregoritsch në dyshim



Donika Gërvalla do të dalë në konferencë për media




Përmblytjet përfshijnë të gjithë Bangkokun, shpallet gjendje...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium





Hebibi vlerëson se statusi aktual i Kosovës si vëzhguese i siguron Prishtinës një bazë institucionale për të kërkuar anëtarësim të plotë. Ai e konsideron të rëndësishme edhe situatën e sigurisë të përmendur nga ministri Glauk Konjufca, pasi sulmet në Banjskë dhe ndaj kanalit të Ibër-Lepencit tregojnë se Kosova përballlet drejtpërdrejt me kërcënime.

Megjithatë, eksperti nënvizon se nevoja për siguri nuk mjafton vetë për të garantuar anëtarësimin. Sipas tij, kushti vendimtar është ndërtimi i një konsensusi politik mes vendeve anëtare.

Për Hebibin, vështirësia kryesore mbetet politike dhe diplomatike. Ai kujton se Kosova e ka paraqitur edhe më herët kërkesën për anëtarësim të plotë, por procesi nuk është përmbyllur. Një nga çështjet më të ndërlukuara ka qenë qëndrimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Prandaj, ai mendon se Prishtina duhet ta riformulojë qasjen e saj dhe të mos mbështetet vetëm te argumenti se Kosova e meriton anëtarësimin. Synimi duhet të jetë bindja e partnerëve se përfshirja e Kosovës do ta forconte Kartën e Adriatikut dhe bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë.

Një nga propozimet e Hebibit është ngritja e një grupi të posaçëm diplomatik për A6, ku do të përfaqësoheshin Presidenca, Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Ky mekanizëm, sipas tij, duhet të ketë një mandat të përcaktuar për identifikimin e shteteve që duhen bindur, argumenteve që duhen përdorur, pengesave që duhet të kapërcehen dhe afateve për secilin veprim.

Në këtë proces, ai e sheh si thelbësore mbështetjen e Shteteve të Bashkuara. Prishtina, sipas tij, duhet të zhvillojë konsultime të drejtpërdrejta me Washingtonin dhe të kërkojë që përkrahja amerikane për integrimin e Kosovës në mekanizmat rajonalë të sigurisë të shprehet qartë.

SHBA-ja është pjesë e A5 dhe partner strategjik i Kosovës, ndaj kjo marrëdhënie, sipas Hebibit, duhet të përdoret në mënyrë më aktive në diplomacinë e Prishtinës.

Një rol të veçantë mund të ketë edhe koordinimi me Tiranën. Hebibi thotë se Shqipëria mund ta mbështesë Kosovën brenda strukturave të A5, si dhe përmes kontakteve dypalëshe me vendet anëtare. Mesazhi që duhet përcjellë, sipas tij, është se anëtarësimi i Kosovës nuk synon të jetë kundër ndonjë shteti, por të kontribuojë në forcimin e sigurisë rajonale.

Duke pasur parasysh se Kroacia do të mbajë presidencën e A5 gjatë vitit 2026, ai kërkon që Kosova të zhvillojë diplomaci intensive me Zagrebin dhe të sigurojë që çështja e saj të ruhet në agjendën e diskutimeve. Sipas Hebibit, kjo përbën një mundësi diplomatike që Prishtina duhet ta shfrytëzojë.

Po ashtu, ai e konsideron të nevojshëm angazhimin me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, prej të cilave Kosova duhet të kërkojë mbështetje dhe koordinim diplomatik për anëtarësimin e saj.

Bosnjë-Hercegovina mbetet një nga çështjet më të vështira, por edhe më të rëndësishme për diplomacinë kosovare. Hebibi sugjeron që Prishtina të punojë drejtpërdrejt me Sarajevën, pa akuza dhe pa ultimatum, duke përcjellë mesazhin se anëtarësimi i Kosovës në A5 nuk përbën një veprim kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, por pjesë të bashkëpunimit rajonal për sigurinë.

Ai propozon gjithashtu identifikimin e faktorëve institucionalë dhe politikë brenda Bosnjës që mund të ndihmojnë në gjetjen e një formule të pranueshme për të gjitha palët.

Sipas Hebibit, Kosova duhet të paraqitet në këtë proces jo vetëm me kërkesën për t'u pranuar, por edhe me një ofertë konkrete për bashkëpunim rajonal. Në këtë ofertë mund të përfshihen lufta kundër kërcënimeve hibride, mbrojtja e infrastrukturës kritike, siguria kibernetike, lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, shkëmbimi i informacionit, trajnimet dhe ushtrimet e përbashkëta, bashkëpunimi civil-ushtarak dhe reagimi i përbashkët ndaj krizave.

Një qasje e tillë, sipas tij, do ta ndryshonte narrativën diplomatike rreth kërkesës për A6. Sulmi në Banjskë dhe ai ndaj Ibër-Lepencit duhet t'u paraqiten partnerëve ndërkombëtarë në mënyrë profesionale, jo vetëm si akuza politike, por si raste që dëshmojnë rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe të bashkëpunimit rajonal në siguri.

Hebibi argumenton se, nëse kërcënimet janë rajonale, atëherë edhe mekanizmat e sigurisë duhet të jenë sa më gjithëpërfshirës.

Në këtë kuadër, ai i kushton rëndësi edhe rolit të KFOR-it. Kosova, sipas tij, duhet të tregojë se prania e KFOR-it dhe partneriteti me NATO-n e SHBA-në nuk e vendosin atë vetëm në pozicionin e përfutteses së sigurisë.

Përkundrazi, Prishtina duhet të dëshmojë se synon të shndërrohet nga një aktor që kërkon siguri në një aktor që kontribuon gjithnjë e më shumë në sigurinë e rajonit. Hebibi e konsideron këtë një argument më të fuqishëm në tryezën diplomatike.

Eksperti sugjeron edhe hartimin e një dokumenti të përbashkët politik me titullin "Kosova A6 Initiative". Në këtë dokument do të duhej të përcaktoheshin arsyet e kërkesës për anëtarësim, kontributi që mund të japë Kosova, përfitimet për sigurinë rajonale, angazhimet e Prishtinës dhe mënyra për adresimin e shqetësimeve të shteteve që kanë rezerva.

Hebibi thekson se një çështje kaq strategjike kërkon koordinim sa më të gjerë politik në Kosovë. Sipas tij, dallimet, kritikën dhe qëndrimet e ndryshme janë të natyrshme, por për sigurinë, integrimin euroatlantik dhe forcimin e pozitës ndërkombëtare duhet të ekzistojë një bashkërendim i gjerë.

Ai vlerëson se debati nuk duhet të fokusohet te pyetja se kush është përgjegjës, por te përcaktimi i partnerëve që duhet të binden, kontributit që Kosova mund t'i japë rajonit, mënyrës së sigurimit të mbështetjes amerikane, shfrytëzimit të presidencës kroate dhe tejkalimit të pengesës politike me Bosnjën dhe Hercegovinën.

Për Hebibin, kërkesa për A6 nuk duhet të mbetet vetëm deklaratë e ministrit të Jashtëm, por duhet të kthehet në një projekt shtetëror diplomatik. Ai e përmbledh qasjen e tij me nevojën për më pak përçarje, akuza dhe retorikë që mbyll dyer, dhe për më shumë diplomaci që krijon mundësi të reja.

Sipas tij, Kosova duhet ta kërkojë anëtarësimin me vendosmëri, por ta ndërtojë atë përmes durimit, argumenteve, aleancave dhe punës së vazhdueshme diplomatike. Kjo do t'i ndihmonte partnerët ta shihnin praninë e Kosovës si një faktor që e forcon sigurinë e përbashkët.

"Askush nuk mund ta ndërtojë të ardhmen i vetëm. Siguria dhe paqja janë më të qëndrueshme kur ndërtohen së bashku", thekson Hebibi.



Eksperti Shëfqet Avdimetaj e sheh si të arsyeshme kërkesën e ministrit Glauk Konjufca për anëtarësim të plotë të Kosovës në Kartën e Adriatikut, sidomos për shkak të situatës së sigurisë në rajon.

Avdimetaj thotë se sulmi në Banjskë dhe ai ndaj kanalit të Ibër-Lepencit dëshmojnë se kërcënimet ndaj Kosovës janë reale. Sipas tij, siguria e vendit është e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rajonale, ndaj Kosova nuk duhet të ketë vetëm një rol periferik, por duhet të kontribuojë në mekanizmat e përbashkët të sigurisë.

Megjithatë, ai e pranon se realizimi i kësaj kërkesë nuk do të jetë i lehtë. Pengesa kryesore, sipas tij, është politike dhe diplomatike, veçanërisht për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga Bosnjë-Hercegovina dhe nevojës për konsensus brenda Kartës së Adriatikut.

Avdimetaj vlerëson se argumentet e Kosovës në fushën e sigurisë janë të rëndësishme, por ato duhet të shoqërohen me angazhim të fortë diplomatik dhe me mbështetje të bashkërenduar nga partnerët ndërkombëtarë.

Sipas tij, iniciativa e Konjufcës mund të shihet edhe si përpjekje për ta rikthyer Kosovën në qendër të diskutimeve mbi arkitekturën rajonale të sigurisë.

Avdimetaj thotë për "Bota sot" se anëtarësimi i plotë nuk është i pamundur, por kërkon konsensus politik dhe punë diplomatike. Nëse Prishtina arrin të sigurojë mbështetje më të gjerë nga shtetet anëtare dhe partnerët euroatlantikë, atëherë kërkesa për A6 mund të marrë një perspektivë më konkrete për realizim.

Shtuar më 26.09.2026 10:23

Tags: [Karta](#), [Konjufca](#), [kosova](#)



Dosti sulmon Ramën pas
fjalimit në OKB: E cilëson
"antishqiptar të betuar de...



Donika Gërvalla do të dalë
në konferencë për media



Protestat kundër aktgjykimit
të Speciales vijojnë:
Prishtina mban sonte nat...



Gani Geci e sheh Anton
Qunin si kandidat të
përshtatshëm për president



Rrustemi: VV-ja do të ftojë
partitë në takime për një
president konsensual



Mehmeti kundër Vuçiqit:
Mohimi i katastrofës
humanitare në Kosovë...



Protesta "Jo në emrin tim"
vijon edhe nën shi, Haziri u
bën thirrje deputetëve të...



Kurti i kërkon Danimarkës
përkrahje për avancimin e
aplikimit të Kosovës drejt...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

[Kontaktimi](#) | [Kushtet e Përdorimit](#) | [Privacy Policy](#) | [Powered by: orihost.com](#)